



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2018

PËR

DISA SHTESA NË LIGJIN NR.55/2015, “PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.55/2015, “Për investimet strategjike”, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 13, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Përfshihet nga përfitimi i statusit subjekt investues strategjik, kur ka të dhëna se subjekti është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

- a) Pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;
- b) Korrupsion;
- c) Mashtrim;
- ç) Pastrim parash ose financim i terrorizmit;

- d) Vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste ose nxitje, ose ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste;
- dh) Organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;
- e) Falsifikim;
- ë) Puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Përfshirja nga shqyrtimi, miratimi dhe mbështetja e investimeve strategjike, zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i një subjekti investues, aksionar ose ortak i tij, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij.”.

b) Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) vërtetim nga dosja gjyqësore ose një dokument, të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 1/1, të këtij neni.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI